

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. S. nga fshati G. e E., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 186/2016, të datës 27.01.2016 të cilën e përfaqësonte Prokurori Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 03.11.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri S. S., nga i ati A., e ëma Z., e lindur D., i lindur ... në fshatin G., ku dhe jeton, nuk din shkrim dhe lexim, ..., martuar-baba i ... fëmijëve, i gjendjes ekonomike të mesme, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse prej datës së pa vërtetuar e deri më datë2015 në kohë të papërcaktuar, shtëpinë e tij në fshatin G. e E., i pandehuri në mënyrë të vazhdueshme dhe të pa autorizuar ka përfutur nga shërbimi komunal-rrjeti i shpërndarjes së rrymës në KEDS, në atë mënyrë që ka bërë lidhje direkte jashtë pikës matëse në tavan me një kabëll 3X2,5 mm² dhe ka shpenzuar energjinë elektrike pa u regjistruar askund si shpenzim, me këtë rast KEDS Distrikti në Gjilan e ka dëmtuar për shumën në vlerë prej rreth 87 euro.

me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton,

DENIM ME KUSHT

Të akuzuarit S. S., i shqiptohet dënim kumulativ me gjobë në shumë prej 300 (treqindë) euro dhe denim me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqindë) ditë, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit S. S., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-s.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 03.11, 2016 Prokurori i Shtetit, Kujtesa Fazliu, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së paraqitur, duke i propozuar gjykatës të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës i KEDS S. M., në fjalën përfundimtare deklaroi: e mbështesë në tërësi fjalën e PSH, i bashkangjitem ndjekjes penale dhe paraqesë kërkesë pasuroro-juridike, në vlerë prej 87.84 €.

I pandehuri S. S., në fjalën përfundimtare deklaroi: e ndijë veten fajtor dhe jam penduar thellë për këtë veprë që e kam kryer, më herët nuk kam kryer vepra penale dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të ngjajshme dhe të tjera penale dhe e lus gjykatën që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë.

Në fillim të shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i akuzuari S. S. ka deklaruar e pranojë fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila më vihet në barrë sipas aktakuzës.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të prokurorit dhe përfaqësuesit të dëmtuarës, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike nga neni 253 të KPP.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari S. S., ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-s, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin S. S., për shkak të kryerjes së veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit S. S., gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë; sjelljen korrekte në gjykatë, se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, është në moshë të shtyer mbi 70 vjeçar, ndërsa rrethana rënduese dashjen për kryerjen e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit kumulativ me kusht, ndaj të akuzuarit S. S., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KP, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij.

Në kuptim të nenit 368 të KPP palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë, duke u paralajmëruar me rëndësinë e dënimit me kusht dhe kushtet të cilat duhet plotësuar që dënimi me kusht mos të revokohet duke u shëndrruar në dënim efektiv.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-s, kurse vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 463 paragrafi 2 të KPP-s. Për arsyet e lartcekura u vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 186/2016, Më 03.11.2016

Sekretarja juridike,
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.